



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2020:049106
Datë: 25.04.2024
Numri i dokumentit: 05618697

C.nr. 3892/2018

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Florian Krasniqi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses: D.M, të cilën me autorizim e përfaqëson avokat L.A nga Mitrovica, kundër të paditurës "...", të cilën e përfaqëson avokat H.S, me objekt kontesti: kompensimin e dëmit, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik, me datë 05.04.2024 mori dhe me datë 25.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses D.M, dhe **DETYROHET** e paditura "...” që paditëses në emër të mos përmbushjes së kontratës, për vitin akademik 2017/2018, për 9 muaj, t’ia paguajë nga 60 euro në muaj, apo shumën totale prej 540 euro, me kamatë ligjore prej 8 % në vit, e cila fillon të llogaritet nga dita e parashtrimit të padisë në Gjykatë e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

II. OBLIGOHET e paditura që paditëses në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t’ia paguajë shumën prej 394,00 euro, brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditësja, me datë 28 Dhjetor 2018 pranë kësaj Gjykate ka paraqitur padi kundër të paditurës "...” për kompensimin e dëmit. Në padi ndër të tjera ka theksuar se, paditësja me datë 23.08.2017 ka lidhur kontratë me të paditurën për studime universitare dhe sipas programit mësimor e njëjta ka filluar studimet në vitin akademik 2017-2018 në programin për studime të integruara evropiane dhe ka ndjekur studimet duke përfunduar vitin e parë me sukses, notën 10. Ka theksuar se gjatë muajve të pushimit Agjencia Kosovare e Akreditimit përmes mjeteve të informimit ka publikuar vendimin për tërheqje të akreditimit për programet e studimit në kolegji dhe po ashtu Agjencia Kosovare e Akreditimit e ka njoftuar paditësen se programi që ka qenë duke studiuar paditësja i ka skaduar akreditimi me datë 20.09.2017, çka nënkupton se për vitin akademik 2017-2018 e paditura nuk ka pasur akreditim në programin e lartë cekur. Tutje ka theksuar se me këto veprime e paditura i ka shkaktuar paditëses dëm të pa kthyeshëm,

duke shkaktuar dëm material dhe jo material.

Në seancë gjyqësore përfaqësuesi i paditëses ka deklaruar se, e paditura ka nënshkruar kontrata me studentë të ndryshëm me programe për të cilat veç se nuk kishin pasur akreditim, dhe që vitit akademik tetor 2017 deri me 30 shtator 2018, sipas vendimit të datës 06.07.2017 i Agjencisë së Kosovës për Akreditim sipas të cilit vendim është pezulluar akreditimi i programeve të studimit për “...” dhe ka ndaluar regjistrimi i studentëve për këtë vit akademik. Ka theksuar se në mungesë të akreditimit viti akademik i paditëses është nul dhe i pa pranueshëm, si në institucionet publike arsimore ashtu edhe në ato private, ashtu që paditësja është dashur që ta ndërpresë shkollimin akademik dhe të regjistrohet në një fakultet tjetër për fillimin e vitit të ri akademik. Ka shtuar se, e paditura nuk ka asnjë provë që i ka zbatuar marrëveshjet që i ka pasur me dy institucionet e tjera arsimore, e për më tepër nuk ka ofruar prova që edhe vet institucionet me të cilat ka pasur marrëveshje të kenë pasur akreditim në programin në të cilin ka vijuar studimet paditësja. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe i ka specifikuar.

E paditura në përgjigje në padi ka theksuar se, paditësja ka lidhur kontratë për studime universitare me të paditurën sipas programit mësimor, ndërsa faktin se paditësja i është referuar vendimit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim me nr. ref. 581/17 datë 06.07.2017, ka rënë në lajthim ngase “...” ka pasur akreditim për vitin 2017 – 2018, ngase vendimi numër 581/17 datë 06.07.2017 i Agjencisë së Kosovës për Akreditim ka qenë i kundërligjshëm, e si i tillë konfirmohet edhe nga procesverbali i inspektoratit të arsimit me nr. të referencës 10, nr. protokolli 684, datë 05.09.2019, ku theksohet se “...” veprimtarinë e vet akademike dhe profesionale për vitin akademik 2017 – 2018 dhe 2018 – 2019 e ushtron bazuar në vendimet për akreditim nga këshilli shtetëror i cilësisë dhe vendimet për licencim të lëshuara nga komisioni për licencim i MASHT-it. Ka theksuar se ndonëse agjencia për akreditim ka lëshuar vendim për pezullimin e programeve të të paditurës, askund në dokumentacionin ligjor të aplikueshëm për fushat përkatëse nuk parashihet një kategori e tillë – pra pezullimi. Ka theksuar se pika kryesore dhe kruciale e kundërligjshmërisë së vendimit nr. ref. 581/17 datë 06.07.2017 qëndron në pikën e fundit të konstatimit të raportit të inspektoratit arsimor kur theksohet se me vendimin nr. ref. 581/17 datë 07.07.2017 Këshilli Shtetëror i Cilësisë “...” nuk ia ndalon regjistrimin e studentëve në ato programe dhe për këtë në vitet pasuese 2018 e më konkretisht me 03.08.2018 Këshilli Shtetëror i Cilësisë nxjerr vendim për tërheqje të akreditimeve të programeve të cekura në vendim, çka do të thotë se pezullimi i programeve është i kundërligjshëm dhe nuk ka mbështetje në ligj dhe si masë e tillë nuk ka mundur ti shqiptohet të paditurës siç edhe është konstatuar në raportin e inspektoratit të arsimit. Ka theksuar se shikuar vendimin nr. 581/17 datë 06.07.2017, theksohet se është pezulluar akreditimi i programeve për një periudhë një vjeçare, si: Ekonomik, Juridik, Studime të Sigurisë (BA), Studime të Sigurisë (MA), e jo edhe për programin ku ka studiuar paditësja D.M dhe e cila ka qenë në Bachelor, programi Studime të Integruara Europiane. Tutje ka theksuar se edhe me vendimin nr. ref. 868/180 datë 03.08.2018 nuk është tërhequr programi në të cilën ka studiuar paditësja por vetëm programet Ekonomik, Juridik, Shkenca Politike, Studime të Sigurisë, por edhe po të ishte tërhequr programi për programit Studime të Integruara Europiane, një gjë e tillë nuk do të vlente në mënyrë retroaktive (ngase vendimi

është i vitit 2018, ndërsa paditësja kërkon kompensimin për vitin 2017-18).

Në seanca gjyqësore përfaqësuesi i të paditurës ka theksuar se paditësja vet ka pretenduar se e ka përfunduar vitin akademik 2017-2018 me notën maksimale 10, pra e paditura i ka ofruar shërbimin, dhe se programi në të cilën ka qenë e regjistruar paditësja nuk është pezulluar me vendimin nr. 581/17 të datës 06.07.2017 e as në vendimin nr. 8081/180 nuk është tërhequr akreditimi për një program të tillë. Ka theksuar se, duke pasur parasysh një gjë të tillë e paditura po ashtu ka pasur marrëveshje me dy institucione të tjera arsimore për që i siguron studentët që në rast të dështimit të paditëses, studentët ti vijnë studimet tek ato institucione arsimore. Ndërsa ka shtuar se, sipas vendimit nr. 461/18D i është vazhduar akreditimi të paditurës sipas kërkesës së vitit 2017, e siç e konstaton edhe vet agjencia për akreditim, ku në arsyetim të vendimit e merr përgjegjësinë për vonesat në vazhdimin e akreditimit. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, bazuar në propozimet e palëve ka zhvilluar procedurën e të provuarit, dhe në këtë çështje juridike kontestimore ka administruar provat si në vijim: Kontrata për studime universitare, 042/17/SIE, data 23.08.2017, komunikimet elektronike – me email, data e printimit 10.04.2018, Vendimi nr. 868/180, Vendimi nr. 581/17 datë 06.07.2017, Kërkesë për Dëmshpërblim, data 09.10.2018, Procesverbal i ri inspektimit, ref. Nr. 10, nr. Protokolli 684, datë 05.08.2019, letër rekomandimi, datë 15.03.2019, referencë, ref.10, nr. protokollit 12, data 16.01.2017, procesverbal, nr. Protokolli 12, data 16.01.2017, Vendimi nr. 559/14, data 04.07.2014, Dëshmitë e pagesave, Vendimi 461/18D, Marrëveshje Bashkëpunimi 06.03.2019, Marrëveshje Bashkëpunimi 30.12.2013.

Gjykata, pasi bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, bazuar në nenin 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim si: LPK), erdhi në përfundimin se padia e paditëses është në tërësi e bazuar, dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese fakti se paditësja me të paditurën kanë nënshkruar Kontratë për vijimin e studimeve universitare, në programin Studime të Integruara Europiane. Po ashtu nuk ishte kontestuese se paditësja kishte vijuar studimet në vitin akademik 2017 – 2018 dhe të njëjtin vit akademik e kishte përfunduar me notën maksimale dhjetë.

Kontestuese në mes të palëve ndërgjyqëse ishte fakti se, nëse e paditura kishte akreditim për programin studimor në të cilin paditësja ishte e regjistruar për të studiuar, dhe po ashtu kontestuese në mes të palëve ishte fakti nëse e paditura ka për obligim kthimin e mjeteve paditëses të paguara nga paditësja në emër të ndjekjes së studimeve universitare tek e paditura.

Nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor vërtetohet fakti se paditësja studimet tek e paditura i ka filluar në vitin akademik 2017/2018, sipas Kontratës për studime universitare 042/17/SIE, data 23.08.2017, në të cilën Kontratë ishte kontraktuar në mes paditëses dhe të paditurës se, e paditura do të regjistrohej tek e paditura për ndjekjen e studimeve në programin Studime të Integruara Europiane, niveli i studimeve Bachelor dhe si kompensim për ndjekjen e

studimeve do të paguante për një vit akademik shumë prej 1,150.00 euro. Kontrata ishte lidhur për një periudhë prej tre viteve. Në nenin 9 të kësaj Kontrate, ishte kontraktuar po ashtu se paditësja pas përfundimit të studimeve tre vjeçare do të merrte gradën Bachelor.

Nga komunikimet elektronike të zhvilluara në mes të paditëses dhe përfaqësuesit të Këshillit Shtetërorë të Cilësisë (në vijim referuar si KSHC), vërtetohet se paditësja në vitin 2018 kishte kërkuar nga këshilli në fjalë që ta informonin nëse të paditurës i ishte pezulluar ose jo akreditimi i programit Studime të Integruara Europiane për vitin akademik 2017-2018, ndërsa e njëjta kishte pranuar përgjigje se të paditurës në vitin 2017 i ishte pezulluar akreditimi për programin në fjalë sipas vendimit të Këshillit Shtetërorë të Cilësisë sipas vendimit 581/2017, datë 06.07.2017, ndërsa sipas vendimit 868/18 i ishte tërhequr akreditimi këtij programi të studimeve.

Nga vendimi nr. 581/2017 i datës 23.06.2017 vërtetohet se KSHC kishte marrë vendim për pezullimin të programit të studimeve për periudhën një vjeçare 1 tetor 2017 – 30 shtator 2018 për programet Ekonomik (BA), Juridik LLB, Shkenca Politike BA, Studime të Sigurisë MA, Studime të Sigurisë BA, dhe në pikën 2 të këtij vendimi i ishte ndaluar regjistrimi i studentëve në vitin akademik 2017 dhe 2018.

Nga vendimi nr. 868/180 i datës 23.07.2018 vërtetohet se KSHC me këtë vendimin kishte tërhequr akreditimi i paditurës për programet: Ekonomik (BA), Juridik LLB, Shkenca Politike BA, Studime të Sigurisë MA.

Ndërsa nga dëshmitë e pagesave, vërtetohet se paditësja kishte paguar në këste të ndara të paditurës shumë prej 540 euro.

Bazuar në vërtetimin e gjendjes faktike, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar, për faktin se e paditura nuk ka përmbushur Kontratën e nënshkruar me paditësen për vijimin e studimeve. Palët me rastin e nënshkrimit të Kontratës kishin kontraktuar që paditësja pas përfundimit të studimeve do të merrte gradën akademike Bachelor, e në kundërvlerë do të paguante vitet akademike për ndjekjen e studimeve. Siç shihet nga dispozitat e Kontratës, e në veçanti nga neni 9 i Kontratës së nënshkruar në mes të palëve ndërgjyqëse, rezulton se palët janë dakorduar që e paditura do të ofronte paditëses shërbimet e ndjekjes së studimeve, dhe pas përfundimit të studimeve paditësja do të merrte gradën Bachelor, ndërsa paditësja për ndjekjen e studimeve tek e paditura do të paguante shumë përkatëse për secilin vit akademik. Pra sipas vet dakordimit të palëve, njëra nga kushtet kyçe të Kontratës gjegjësisht të detyrimeve të të paditurës karshi paditëses, ka qenë që e paditura ti mundësonte marrjen e gradës Bachelor në programin e studimeve në të cilat e njëjta ishte regjistruar. Sipas Ligjit Nr. 04/L-037 për arsimin e lartë, gjegjësisht neni 14, paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 i këtij ligji, parashihet që 5. *Kërkesa të tjera shtesë për licencimin e bartësve privatë të arsimit të lartë përshkruhen më poshtë në këtë ligj dhe në dokumentet plotësuese të nxjerra mbi bazën e tij. Si minimum, këto kërkesa shtesë do të përfshijnë si në vijim: 5.5. akreditimin në nivel institucional si dhe në atë të programeve nga ana e AKA ose ndonjë organi tjetër i njohur për akreditim, dhe i miratuar nga AKA;* sipas kësaj dispozite ligjore, rezulton se është kusht i domosdoshëm që një institucion privat i arsimit të lartë

të mund të ofrojë shërbimet e arsimit universitar, duhet të ketë akreditim të programeve.

Nga provat e administruara në shqyrtim gjyqësor është vërtetuar se, në kohën kur paditësja ka regjistruar studimet, pra në vitin e parë akademik, e paditura nuk kishte pasur të akredituar programin Studime të Integruara Europiane, kjo për faktin se, nga vendimi 559/14 datë 04.07.2014, ishte ri akredituar programi Studime të Integruara Europiane, për periudhën 01.10.2014 deri me 30.09.2017, ndërsa me datë 30.09.2017 kishte skaduar akreditimi i këtij programi. Për më tepër e paditura gjatë zhvillimit të procedurës kontestimore nuk ka ofruar asnjë provë për të argumentuar të kundërtën e këtij fakti, pra ka dështuar të provojë faktin se programi në të cilin ka qenë e regjistruar paditësja ka pasur akreditim pas datës 30.09.2017.

Bazuar në këto konstatime si më lartë, gjykata vlerëson se e paditura nuk ka përmbushur në tërësi Kontratën ashtu siç e njëjta ka qenë e kontraktuar në mes të palëve ndërgjyqësore, dhe rrjedhimisht viti shkollor i ndjekur nga paditësja tek e paditura nuk ka qenë i vlefshëm, në mungesë të akreditimit të programit përkatës mësimor.

Duke u bazuar në faktin se, e paditura nuk e ka përmbushur Kontratën siç e njëjta ka qenë e nënshkruar, dhe duke u bazuar në atë se është provuar në procedurë gjyqësore se e paditura nuk ka pasur akreditim në periudhën në të cilën ka vijuar studimet paditësja (viti i parë i studimeve), gjykata vlerëson se duhet të zbatohen rregullat e mos përmbushjes së Kontratës dhe e paditura të detyrohet për kthimin e pagesave të cilat paditësja i ka realizuar në emër të pagesës së vitit akademik 2017-2018. Në këtë kuptim, Ligji nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve në nenin 106 rregullon si në vijim: *Në kontratat e dyanshme, kur njëra palë nuk e përmbushë detyrimin e saj, pala tjetër mundet, në qoftë se nuk është caktuar diç tjetër, të kërkojë përmbushjen e detyrimit ose, në kushtet të parashikuara në nenet e mëposhtëm, ta zgjidhë kontratën me deklaratë të thjeshtë, në qoftë se zgjidhja e kontratës nuk krijohet sipas vetë ligjit. Në çdo rast ka të drejtë në shpërblimin e dëmit.* Bazuar në interpretimin e kësaj dispozite ligjore, rezulton se paditësja sipas dispozitave ligjore ka pasur të drejtën e shkëputjes së Kontratës, si dhe në emër të mos përmbushjes së Kontratës të kërkojë kthimin e të gjitha pagesave të cilat e njëjta i ka bërë gjatë vitit akademik 2017-2018. Pra, sipas vlerësimit të Gjykatës, paditësja i ka lindur e drejta që të kërkojë kthimin e mjeteve, nga vet fakti se pala tjetër nuk ka përmbushur në tërësi Kontratën e dyanshme detyruese. Meqenëse paditësja i ka lindur e drejta e kthimit të mjeteve, Gjykata vlerëson se në mes të palëve ndërgjyqëse është krijuar raport juridik kreditor – debitor dhe paditësja ka të drejtën e kërimit të përmbushjes së detyrimit në emër të mos përmbushjes së Kontratës, kjo duke u bazuar në nenin 245 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, i cili përcakton: *1. Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij.*

Bazuar në të gjitha këto, gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësjes, dhe ka detyruar të paditurën që për shkak të mos përmbushjes së Kontratës, paditësja t'ia paguajë shumën prej 540 euro. Lartësinë e kërkesëpadisë, gjykata e ka vërtetuar duke u bazuar në dëshmitë e pagesave të ofruara nga paditësja e të njëjtat të administruara si prova në shqyrtim gjyqësor, ndërsa lartësia

dhe fakti se këto pagesa i janë paguar të paditurës nga paditësja nuk është kontestuar as nga pala e paditur.

Gjykata me rastin e vendosjes i ka shqyrtuar edhe pretendimet e tjera të palës së paditur. E paditura ka pretenduar se Vendimi nr. 581/17 datë 06.07.2017 dhe Vendimi nr. 868/180, të nxjerre nga KSHC kanë pezulluar pa bazë ligjore e më vonë po ashtu tërhequr pa bazë ligjore akreditimin në programet e caktuara të paditurës, e po ashtu e paditura ka pretenduar se sipas këtyre dy vendimeve janë pezulluar gjegjësisht tërhequr akreditimi për disa programe tjera studimore, por jo edhe për programin në të cilin ka qenë e regjistruar paditësja. Sipas vlerësimit të gjykatës ky pretendim nuk ka ndikim në një vendosje ndryshe, ngase qëndron fakti se në vendimet në fjalë nuk figuron edhe programi i studimeve Studime të Integruara Europiane, megjithatë nga provat tjera të administruara është vërtetuar se akreditimi i programit mësimorë Studime të Integruara Europiane ka skaduar me datë 30.09.2017, ndërsa e paditura nuk ka ofruar asnjë provë në shqyrtim gjyqësor me të cilin do të argumentonte se programi mësimor në fjalë është ri akredituar.

E paditura po ashtu ka pretenduar se, me vendimin nr. 461/18D, të paditurës i është zgjatur periudha e akreditimit për periudhën një vjeçare, 1 tetor 2021 – 30 shtator 2022, megjithatë ky pretendim është i pabazuar, për faktin se sipas nenit 14 të Ligjit për Arsimin e lartë, neni 5 pika 5.5 parashihet që institucioni përkatës në mënyrë që të jetë bartës i arsimit të lartë duhet të dëshmojë se ka *5.5. akreditimin në nivel institucional si dhe në atë të programeve nga ana e AKA ose ndonjë organi tjetër i njohur për akreditim, dhe i miratuar nga AKA*. Pra sipas kësaj dispozite kërkohen dy lloje të akreditimit dhe atë, akreditimi institucional dhe ai i programeve, ndërsa sipas vendimit të administruar si provë e të paraqitur nga e paditura, në pikën I të këtij vendimi është përcaktuar se zgjatet periudha e akreditimit institucional, pra jo edhe e akreditimit të programeve, e për më tepër ky vendim i referohet periudhës 01.10.2021 deri 30.09.2022, ndërsa vendimi është i lëshuar me datë 10.05.2018, pra nuk rregullon çështje të akreditimit të programeve për periudhën kontestuese.

E paditura po ashtu ka pretenduar se e njëjta ka pasur marrëveshje me dy institucione të tjera të arsimit të lartë, Marrëveshje Bashkëpunimi 06.03.2019 dhe Marrëveshje Bashkëpunimi 30.12.2013, me qëllim të mbrojtjes së studentëve në rast të mbylljes së institucionit, megjithatë edhe ky pretendim sipas vlerësimit të kësaj gjykate nuk ka ndikim në një vendosje ndryshe. Qëndron fakti se pala e paditur ka pasur marrëveshje me institucione tjera të arsimit të lartë, mirëpo në procedurë gjyqësore e paditura nuk ka ofruar asnjë provë me të cilën do të provonte faktin se i ka ofruar paditëses që për shkak të mungesës së akreditimit, studimet ti vijojë tek institucionet tjera me të cilat ka pasur marrëveshje bashkëpunimi, e për më tepër vet e paditura gjatë tërë procedurës gjyqësore e ka kundërshtuar faktin se nuk kanë pasur akreditim, çka e bën këtë pretendim të të paditurës edhe kontradiktor.

Sa i përket kamatës, Gjykata ka vendosur që e paditura shumë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, paditëses t'ia paguajë me kamatë ligjore prej 8% në vit, kjo duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së i cili përcakton: *1. Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të*

holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën. 2. Lartësia e kamatëvonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.

Gjykata vendosi që e paditura të obligohet për pagimin e shpenzimeve të procedurës, duke u bazuar në nenin 452 të LPK-së, i cili përcakton: *452.1 Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyq fituese, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t'ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore.* Në këtë kuptim, referuar dispozitës ligjore të lartë cituar, Gjykata ka vendosur që të detyrojë të paditurën që, paditëses t'ia paguajë shpenzimet e procedurës, në shumën prej 394,00 euro, dhe atë sipas specifikimit të palës paditëse, 104 euro në emër të përpilimit të padisë, për pjesëmarrjen në dy seanca, për secilin nga seancat shumë prej 135,00 euro, si dhe në emër të taksës gjyqësore shumë prej 20 euro.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat, bazuar në nenin 160 të LPK-së, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-
Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.3892/2018, datë 25.04.2024

Gjyqtari
Florian Krasniqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.